



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi e Zbatuar

Ngarkesa mësimore: 4 kredite; 50 orë mësim; 30 leksione / 10 seminare

Viti / Semestri: Viti i parë, Semestri i dytë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit : Master Mësuesi

Kodi i etikës: Kodi i Etikës së Universitetit të Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të përgatisë studentët për zbatimin praktik të njohurive në fushën e gjuhësisë. Të pajisë studentët me aftësi për mësimdhënien e fonetikës, gramatikës dhe leksikologjisë. Të ndihmojë në identifikimin e karakteristikave të përbashkëta, të pjesshme dhe të ndryshme mes gjuhës shqipe dhe gjuhës greke.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të parandalojë gabimet në mësimdhënien e greqishtes për shqiptarët dhe të shqipes për greqishtfolësit.

2. Të shmangë gabimet gjatë përkthimit nga greqishtja në shqip dhe anasjelltas.